




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 201 Prot

Shkodër me 31.03 2026

V E N D I M

Nr. 01, Datë 27.03.2026

“PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR FINANCIM NGA FONDI SOCIAL, PËR NGRITJEN APO VAZHDIMËSINË E SHËRBIMEVE TË OFRUARA ME MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE, PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2027”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Specialisti I Çështjeve Sociale “Për miratimin e kërkesave për financim nga fondi social, për ngritjen apo vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara me marrëveshje bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse për Këshillin e Qarkut Shkodër për vitin 2027”, bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 2, të nenit 48 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 224, datë 09.04.2024 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, shkresës nr.1136, datë 16.02.2026 “Njoftim për paraqitjen e kërkesave për financim nga Fondi Social për vitin 2027”, Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **14 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,**

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesave për financim nga fondi social për ngritjen apo vazhdimësinë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të ofruara me marrëveshje bashkëpunimi me organizatat

jofitimprurëse dhe përkatësisht:

- a. Financim për Qendrën Rezidenciale Shtëpi-Familje Madonnina della Grappa”, për vazhdimësinë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2027, për financim nga fondi social në shumën **6,862 mijë lekë**.
 - b. Financim për Qendrën Ditore “Buzëqeshja e Motër Lezes”, Madonnina della Grappa”, për vazhdimësinë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2027, për financim nga fondi social në shumën **9,784 mijë lekë**.
 - c. Financim për Qendrën Rezidenciale Shtëpi-Familje” Shtëpia Rregullatore e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative” Bushat, për vazhdimësinë e shërbimeve për vitin 2027, për financim nga fondi social në shumën **14,212 mijë lekë**.
 - d. Financim për Strukturën Rezidenciale “Strehëz për Viktimat e Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, nga Shoqata “Komuniteti Papa Xhovani XXIII”, për ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2027, për financim nga fondi social në shumën **6,891 mijë lekë**.
 - e. Financim për projektin “Shërbim i integruar dhe i specializuar për ndërhyrje zhvillimore për fëmijët me çrregullime neurozhvillimore në Qarkun Shkodër”, ofruar nga Fondacioni ILIOS, për ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2027, për financim nga fondi social në shumën **2,493 mijë lekë**.
 - f. Financim për projektin “Fuqizimi i Jetës përmes Natyrës: Rehabilitim dhe Përfshirje Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara” ofruar nga shoqata The DOOR Albania, për ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2027 për financim nga fondi social në shumën **6,710 mijë lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
 3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

